



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 162/3 prot.

Tiranë më 13 . 2 .2018

REKOMANDIM

Nr. 04 , datë 13 . 2 .2018

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Baza Ligjore: Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, nënart 30, 31 dhe 32 të tij.

Në zbatim të Urdhrit Nr.38 datë 24.01.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Përmbaruesi Gjyqësor Privat Desian Brahimllari - “Elite Bailiff’s Office” shpk, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Përmbarues Gjyqësor Privat Desian Brahimllari - “Elite Bailiff’s Office” shpk.

Në funksion të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Zyrat Përmbarimore Private, janë kontrollues të cilët mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale për kategoritë “punonjës” dhe “subjekte të dhënash” për të cilët është marrë vendim ekzekutimi.

Kontrolluesi Përmbarues Gjyqësor Privat Desian Brahimllari - "Elite Bailiff's Office" shpk, është subjekt juridik me NIPT: L31328001M dhe objekt aktiviteti "Shërbim përmbarimor privat".

Kontrolluesi, në ushtrim të detyrës së tij, ka kryerjen e shërbimit përmbarimor privat gjyqësor dhe konkretisht ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Përfaqësuesi i kontrolluesit u njoh me Urdhrin nr. 38 datë 24.01.2018 të Komisionerit dhe u tregua bashkëpunues me grupin e inspektimit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim, në datë 30.01.2018 u konstatua se:

1. Kontrolluesi nuk ka "Njoftuar" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Konstatimi përbën shkelje administrative të neneve 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.
2. Kontrolluesi nuk disponon rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti", megjithëse konstatohet se ka klauzola specifike në lidhje me konfidencialitetin në kontratën me punëmarrësin. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.
4. Kontrolluesi mbikëqyr nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) ambientet në të cilat ushtron aktivitetin si hyrjen, korridore dhe zyra. Koha e ruajtjes së të dhënave imazhe-video në sistemit e video-vëzhgimit (CCTV) është 20 ditë. Konstatohet që subjektet e të dhënave nuk informohen nëpërmjet tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV). Konstatimi në lidhje me mbikëqyrjen e zyrave nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) përbën shkelje administrative të nenit 5 ("1/b - në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime"), nenit 6 (Kriteret ligjore për përpunimin) të Ligjit si dhe Udhëzimit Nr.11 datë 08.09.2011 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat": "10.2- Kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret për mbikëqyrjen e një punonjësi në vendin e punës. Kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret në tualete, dhomat e ndërrimit apo vende të tjera të ngjashme, ose në dhomat e punës të caktuara për përdorim personal të punonjësve".

Konstatimi në lidhje me mungesën e informimit të subjekteve të të dhënave sa i përket mbikëqyrjes së ambienteve nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), përbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit - *"1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij."*

5. Konstatohet se kontrolluesi nuk ka vendosur politikat e privatësisë në portalin zyrtar <http://www.elitebailiff.al>.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit - *"1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit..."*

Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale dhe pavarësisht nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet portalit online në internet, ka detyrim që të publikojë *"Politikat e Privatësisë"*, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash, realizohet nëpërmjet portalit zyrtar të kontrolluesit. Publikimi i *"Politikave të Privatësisë"* përmbush më së miri qëllimin që ka neni 18 i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, grupi i kontrollit hartoi proces verbalin i cili u lexua në prani të palëve. Përfaqësuesi i kontrolluesit deklaroi me shkrim në procesverbal se: *"Nga sa u parashtrua më lartë nga inspektorët, konstatimet qëndrojnë dhe nga ana e subjektit Elite Bailiff's Office shpik filluan për tu marrë masa për plotësimin e pikave të konstatuara. U plotësuan deklaratat e punonjësve, u vendosën tabelat informuese të kamerave dhe u krye regjistrimi online"*.

Kontrolluesi vuri në dispozicion të grupit të hetimit administrativ:

- Një kopje të *"Deklaratës së Konfidencialitetit"* sipas modelit standard të miratuar në Vendimin nr. 6 të Komisionerit datë 05.08.2013 për *"Përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale."*
- Një fotografi të tabelës informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV), ndonëse nuk ishte sipas modelit standard të miratuar nëpërmjet Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit datë 05.03.2010 *"Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera"*.
- Një kopje të *"Njoftimit"* të kryer pranë Zyrës së Komisionerit.

Zyra e Komisionerit, mban në konsideratë faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e hetimit administrativ gjatë ushtrimit të kontrollit dhe ka rikuperuar pjesërisht në mënyrë të menjëherëshme disa nga konstatimet e grupit të kontrollit.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 27 dhe 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Përmbarues Gjyqësor Privat Desian Brahimllari - "Elite Bailiff's Office" shpk, në zbatim të neneve 5 dhe 6 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.11 datë 08.09.2011 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat":
 - a. Të ndalojë mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të video-survejjimit në zyrat e administratës;
 - b. Të mos përdorë kamera në zyrat e administratës;
 - c. Të shkatërrojë të gjitha të dhënat personale imazhe-video të cilat ndodhen në sistemin e video-survejjimit (CCTV), të regjistruara nga kamerat e vendosura në zyrat e administratës.
2. Kontrolluesi Përmbarues Gjyqësor Privat Desian Brahimllari - "Elite Bailiff's Office" shpk, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të informojë subjektet e të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre në raste cënimi, nëpërmjet tabelës informuese sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri me Udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera";
3. Kontrolluesi Përmbarues Gjyqësor Privat Desian Brahimllari - "Elite Bailiff's Office" shpk, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të publikojë e Politikat e Privatësisë në portalin zyrtar <http://www.elitebailiff.al>;
4. Kontrolluesi Përmbarues Gjyqësor Privat Desian Brahimllari - "Elite Bailiff's Office" shpk, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të hartojë Rregulloren për "Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale".
5. Kontrolluesi Përmbarues Gjyqësor Privat Desian Brahimllari - "Elite Bailiff's Office" shpk, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në këtë Rekomandim, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dëjani.
6. Në rast mos përbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i

ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13/12/2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

